REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT
KABINETI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË SHTETIT
SEKTORI PËR KOMUNIKIMIN ME MEDIAN DHE PUBLIKUN

Tiranë, më 06.11.2026

Lënda: Kthim përgjigjje
Drejtuar: Zj. Jona Cenameri

Në vijim të përgjigjjes për kërkesën tuaj, informojmë:

Projekti "Smart City" mbështetet në kompetencat ligjore të Policisë së Shtetit dhe MPB-së për sigurinë publike, zbaton garanci juridike, teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, kufizon aksesin vetëm për personat e autorizuar, parashikon afate të përcaktuara ruajtjeje dhe nënvizon se inteligjenca artificiale përdoret vetëm si mjet mbështetës, pa prodhuar automatikisht pasoja juridike apo vendime administrative.

Përpunimi i të dhënave në kuadër të projektit "Smart City" do të realizohet në përputhje me Ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", duke respektuar të gjitha parimet dhe garancitë për mbrojtjen e të dhënave personale.

Baza ligjore e projektit mbështetet në Ligjin nr. 82/2024 "Për Policinë e Shtetit", Ligjin nr. 19/2016 "Për masat shtesë të sigurisë publike", Ligjin nr. 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", Ligjin nr. 25/2024 "Për sigurinë kibernetike", si dhe Kodin Rrugor për komponentët që lidhen me sigurinë rrugore. Përpunimi kryhet vetëm për qëllime të ligjshme që lidhen me sigurinë publike, rendin publik dhe sigurinë rrugore.

Platforma përdor funksionalitete të inteligjencës artificiale për identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e situatave që lidhen me sigurinë publike. Funksionalitetet e inteligjencës artificiale përdoren si mjete mbështetëse për identifikimin dhe analizimin e situatave të lidhura me sigurinë publike dhe sigurinë rrugore. Rezultatet e sistemit nuk prodhojnë automatikisht pasoja juridike dhe nuk përbëjnë bazën e vetme për vendimmarrje. Çdo veprim i mëtejshëm i nënshtrohet verifikimit nga autoritetet kompetente.

Projekti i nënshtrohet mbikëqyrjes së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me kompetencat e tij ligjore.

Aksesi në sistem lejohet vetëm për persona të autorizuar dhe sipas parimit "need-to-knoë". Çdo akses, konsultim apo veprim në sistem regjistrohet automatikisht dhe është i gjurmueshëm.
Pamjet video ruhen deri në 30 ditë, ndërsa alertet dhe metadatat ruhen deri në 1 vit. Në rastet kur lidhen me hetime apo procedura administrative ose penale, afati mund të zgjatet sipas nevojës ligjore. Pas përfundimit të afateve përkatëse, të dhënat fshihen ose anonimizohen në mënyrë të sigurt. Kjo masë zbatohet edhe për të dhënat e derivuara nga analiza, sipas politikave të ruajtjes së sistemit.

Kontrata e shërbimit është lidhur ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe shoqërisë Presight AI LTD. Megjithatë, sipas nenit 22 të kontratës, ajo përmban dispozita konfidencialiteti që kufizojnë publikimin e kontratës dhe dokumentacionit të lidhur me të. Për këtë arsye, kontrata

dhe specifikimet teknike nuk mund të vihen në dispozicion përtej rasteve të parashikuara në kontratë dhe legjislacionin në fuqi.

Lista e shkollave:

1. Shkolla Teknike Ekonomike;
2. Shkolla e Mesme Profesionale (6A);
3. Shkolla e Mesme Profesionale (6B);
4. Shkolla e Mesme e Ndërtimit;
5. Shkolla 9-vjeçare ‘’Fan S. Noli’’;
6. Shkolla 9-vjeçare ‘’Marie Logoreci’’;
7. Shkolla 9-vjeçare ‘’Kongresi i Manastirit;
8. Shkolla 9-vjeçare ‘’Ramazan Jarani’’;
9. Shkolla 9-vjeçare ‘’Ahmet Gashi’’;
10. Shkolla 9-vjeçare ‘’Gjon Buzuku’’;
11. Shkolla 9-vjeçare ‘’Bajram Curri’’;
12. Shkolla 9-vjeçare ‘’Avni Rusteni’’;
13. Shkolla 9-vjeçare ‘’Jeronim de Rada’’;
14. Shkolla 9-vjeçare ‘’Hoxha Tasim’’.
15. Gjimnazi ‘’Petro Nini Luarasi’’;
16. Gjimnazi ‘’Ibrahim Rugova’’;
17. Gjimnazi ‘’Isa Boletini’’;
18. Gjimnazi ‘’Qemal Stafa’’;
19. Gjimnazi ‘’Partizani’’;
20. Gjimnazi ‘’Aleks Buda’’.

Faleminderit për bashkëpunimin!

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit